



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:084871
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05713915

K.Dh.Shk.II.nr.404/2024

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, e përbërë nga gjyqtari individual Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Inspektoriati i Punës, rruga “Vëllezërit Gërvalla” (Administrata Pensionale-kati i III, zyra nr.1), ndaj debitorit “Viva Fresh” Sh.p.k me seli në Graçanicë magjestrallja Prishtinë-Lipjan-Suhadoll, me NUI:810670390, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra ligjore “Pro Juris” me seli në Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.619/23 dt.20.11.2023, me datën 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “Viva Fresh” Sh.p.k me seli në Graçanicë, dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.619/23 dt. 20.11.2023.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.619/23 dt.20.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Viva Fresh”Sh.p.k me seli në Graçanicë, ushtruar kundër urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.15/2023 të datës 08.03.2023, sipas propozimit të kreditorit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Inspektoriati i Punës.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkakë të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materilaë, me propozim që ankesë e debitorit të aprovohet si e bazuar dhe të priset aktvendimi i ankimuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Kreditori nuk ka paraqit përgjigje në ankesë edhe pse të njejtën e ka pranuar me datën 29.12.2023.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore provat veç e veç dhe lidhshmërin e tyre, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Inspektoriati i Punës, me datën 07.03.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim, ndaj debitorit “Viva Fresh”Sh.p.k me seli në Graçanicë, në bazë të Vendimit nr.164/2022 të datës 08.03.2023, lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve–Inspektoratit i Punës, në vlerën prej 8.800.00euro.

Përmbaruesi Privat duke vendosur lidhur me propozimin për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë aktvendimin P-15/2023 të datës 08.03.2023 me të cilin e ka lejuar përmbarimin.

Ndaj këtij aktvendimi debitori, ka ushtruar prapësim, duke e kundërshtuar urdhërin përmbarimor, për për shkak se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhëri nuk është i përshtatshëm për

përmbarrim, dhe se është vërtetim i gabuar i gjendjes faktike. Po ashtu ka cek se vendimi i Inspektoriatit të punës është në kundërshtim me nenin 24 par 3 të LPP-së, ngase për këtë çështje me datën 24.02.2023 është paraqitur padi për anulimin e vendimit të organit administrativ dhe se me paraqitjen e kësaj padie e bënë vendimin e tillë të papërmbarrushëm duke mos i plotësuar tiparet për përmbarrushmëri, dhe ka propozuar që ta pranoj si të bazuar prapësimin, të anulohet urdhëri përmbarrimor.

Përgjigje ndaj prapësimi ka parashtruar kreditori ku ka cek se mbetet në tërësi pranë theksimeve të paraqitura në arsyetimin e vendimit të Inspektoriatit të Punës duke kërkuar që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas analizimit të shkresave në lëndë dhe prapësimi, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.619/23 të datës 20.11.2023, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke vendosur më si në dispozitiv të të njëjtit. Me arsyetim se vendimi nr.164/2022 i datës 29.07.2022 në bazë të cilës është caktuar përmbarrimi është bërë i plotëfuqishëm me datën 01.02.2023 dhe i ekzekutushëm me datën 01.02.2023. Ndaj gjykata vleron se i njëjti është dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par 1.2 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore.

Gjykata e Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së neni 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Ministris së Financave dhe Transfereve-Inspektorët e Punës me nr. 164/2022 i datës 29.07.2022, në rastin konkret është dokument përmbarrues, kjo parashihet ne nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: “*Dokument përmbarrues është edhe vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative*” dhe përbën bazën juridike për caktimin e

përmbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.E që në rastin konkret i njëjti përmbanë të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori si dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Në këtë rast Vendimi i lëshuar nga Ministris e Financave dhe Transfereve -Inspektorati i Punës me nr. 164/2022 i datës 29.07.2022 është dokument përmbarimor dhe i përmbarueshëm dhe cilësia e tillë i është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë dhe të ekzekutueshmërisë të datës 01.02.2023 dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e borxhit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Po ashtu vendimi si dokument përmbarimor, ka cilësinë e titullit ekzekutiv dhe është i përmbarueshëm, pasi që i njëjti është i pajisur me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën për ekzekutueshmëri dhe si i tillë konform nenit 36 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, sipas këtij titulli përmbarimi në këtë rast është i lejuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit sepse gjykata apo përmbaruesi privat në procedurë përmbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata-përmbaruesi privat e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimore, vlerëson nëse janë plotësuar kushte për nxjerrjen e urdhrin përmbarimor dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata e shkallës së parë i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore lidhur me at se vendim mbi bazën e së cilit është lejuar urdhëri përmbarimorë kemi bërë padi pranë gjykatës, mirëpo lidhurë me këtë pretendim gjykata e shkallës së parë e ka dhën sqarime të mjaftushëm me të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, andaj një pretendim të till e refuzoi si të pa bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
K.DH.SH.II nr.404/24, me datë 20.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri